



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 28

Tiranë – E enjte, 23 shkurt 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 8/2023, datë 16.2.2023	Për rrëzimin e kërkesës për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Kuvendit..... 2623
Vendim i Kuvendit nr. 9/2023, datë 16.2.2023	Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit të pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve..... 2623
Vendim i Kuvendit nr. 10/2023, datë 16.2.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 28/2020, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”..... 2623
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 3, datë 15.2.2023	Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike..... 2626
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 5, datë 17.2.2023	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2022-2023 (sesioni i parë)..... 2628
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 77, datë 15.2.2023	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar..... 2629
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 82, datë 16.2.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë.. 2632
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 87, datë 20.2.2023	Për delegim kompetencash..... 2632

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 12, datë 27.1.2023	Mbi heqjen e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nr. 134, seria PV11K, të shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.....	2633
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 16, datë 6.2.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2023 për shoqëritë ujësjellës-kanalizime, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.....	2636
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 17, datë 6.2.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.....	2638
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 18, datë 6.2.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2641
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 21, datë 9.2.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2642
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 22, datë 9.2.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	2642
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 9.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2643
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 24, datë 9.2.2023	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	2645
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 25, datë 9.2.2023	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	2646
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 9.2.2023	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “SUN POWER 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	2647
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Osman Nexhi.....	2648

**VENDIM
Nr. 8/2023****PËR RRËZIMIN E KËRKESËS PËR
SHKARKIMIN NGA DETYRA
TË KRYETARIT TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 75 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe nenit 114, pika 4, të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Rrëzimin e kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra të Kryetares së Kuvendit, zonjës Lindita Nikolla.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)**

Miraturar në datën 16.2.2023.

**VENDIM
Nr. 9/2023****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË
PAGAVE TË PERSONELIT ME KOHË JO
TË PLOTË PUNE, QË REKRUTOHET
PËR REALIZIMIN E PROCESIT TË
PILOTIMIT TË VOTIMIT DHE
NUMËRIMIT ELEKTRONIK NË
ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2023,
TË KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 19, shkronja “m”, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit të pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit të pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)**

Miraturar në datën 16.2.2023.

Lidhja 1

Drejtoria	Pozicioni punës	Kategoria e pagës	Periudha	Nr. i punonjësve	Kriteret e punësimit
Drejtoria e Logistikës dhe Digitalizimit	Specialist PEVN	IV-b	3 muaj	14	Arsim i lartë/Informatikë/ TIK/Shkenca Komputerike.
	Operatorë PEVN	V	3 muaj	24	Arsim i detyruar
	TOTAL			38	

**VENDIM
Nr. 10/2023****PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 28/2020, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS ORGANIZATIVE,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT
TË PAGAVE TË PERSONELIT TË
INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 197, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 28/2020, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ndryshohen, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)

Miraturar në datën 16.2.2023.

Lidhja nr. 1


ORGANIKA E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. INSPEKTOR I LARTË IDREJTËSISË	G-3	<u>1</u>
KABINETI		(11)
KËSHILLTARË	Barazohet në pagë me Zëvendësministrin	9
NDIHMËS	III-a	1
SEKRETAR	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	1
II. TRUPA E INSPEKTORËVE		(20)
INSPEKTOR MAGJISTRATË	G-2	10
INSPEKTOR JO MAGJISTRATË	I-b	10
III. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	I-a	<u>(1)</u>
IV. NJËSIA E NDIHMËS INSPEKTORËVE		<u>(23)</u>
NDIHMËS INSPEKTOR	II-b	23
V. DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE		(8)
DREJTOR	II-b	1
1. SEKTORII HARTIMIT TË AKTEVE DHE PËRPUTHSHMËRISË		(2)
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	III-b	1



2. SEKTORII ANALIZËS DHE STUDIMEVE		(2)
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	III-b	1
3. SEKTORII PËRFAQËSIMIT DHE RAPORTIMEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
VI. DREJTORIA E ANALIZËS DHE STANDARDEVE		(7)
DREJTOR	II-b	1
1. SEKTORII METODIKËS DHE STANDARDEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
2. SEKTORII STATISTIKAVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
VII. DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(30)
DREJTOR	II-b	1
1. SEKTORII BUXHETIT DHE FINANCËS		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
2. SEKTORII BURIMEVE NJERËZORE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST (BURIME NJERËZORE)	III-b	1
SPECIALIST REDAKTOR	III-b	1
3. SEKTORII ARKIV PROTOKOLLIT		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST (ARKIV/PROTOKOLL)	III-b	4
4. SEKTORII TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST IT	III-b	2
5. SEKTORII ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
6. SEKTORII SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME		(11)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST PROKURIME	III-b	1
SPECIALIST SHËRBIME	III-b	1
PUNONJËS PASTRIMI		1
SHOFER		4
MAGAZINIER		1
NËPUNËS INFORMACIONI		1
PUNËTOR MIRËMBAJTJE		1

TOTALI 101



UDHËZIM

Nr. 3, datë 15.2.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E DIPLOMAVE
UNIVERSITARE TË NJËVLERSHME, TË
NGJASHME OSE TË PËRAFËRTA ME
FUSHËN/LËNDËT E MËSIMDHËNIES
NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE
KRITERET PËR HAPJEN E
PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË
FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN
PSIKO-PEDAGOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I

**KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E
DIPLOMËS UNIVERSITARE TË
NJËVLERSHME, TË NGJASHME OSE TË
PËRAFËRT ME FUSHËN/LËNDËT E
MËSIMDHËNIES NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR**

1. Profesioni i mësuesit në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, mund të ushtrohet edhe nga individë që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) zotërojnë diploma të programeve të studimit të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur së paku 4 (katër) vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas primeve të procesit të Bolonjës, diplomë universitare të ciklit të parë dhe ciklit të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimitdhënies në arsimin parauniversitar;



b) zotërojnë certifikatë për formimin psiko-pedagogjik, të lëshuar nga institucione të arsimit të lartë (IAL), që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar në fushën e mësuesisë.

2. Diplomë e njëvlershme, e ngjashme ose e përafërt për ushtrimin e profesionit të mësuesit do të konsiderohet, plotësimi i kriterëve si vijon:

a) Diploma e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” të jetë në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

b) Diploma e ciklit të dytë “Master i shkencave” / “Master i arteve” ose “Master profesional” me 120 kredite apo ekuivalente me to, të lëshuara nga institucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilës të përputhet me një nga fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, të përcaktuara në aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

KREU II

KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE

1. Programet e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë që kanë programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e mësuesisë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

2. Programet e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike organizohen me jo më pak se 30 kredite dhe me kohëzgjatje normale një semestër.

3. Kërkesa për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

a) propozimin e njësisë bazë ku do të ofrohet programi i studimit;

b) vendimin e senatit akademik dhe bordit të administrimit për miratimin e hapjes së programit;

c) planin mësimor dhe planin lëndor (*syllabus*) e moduleve/lëndëve;

d) rregulloren e programit të studimit;

e) listën e plotë emërore të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për programin e studimit, ngarkesën mësimore dhe formën e punësimit, si dhe titullin akademik dhe gradën shkencore përkatëse;

f) dosjen e personelit e cila përmban:

i. kontratat e punës me personelin e planifikuar për t'u angazhuar me kohë të plotë, në rast të hapjes së programit ose vërtetimit nga rektori mbi kategorinë e personelit akademik dhe kohëzgjatjen e kontratës me ose pa afat të caktuar;

ii. dëshmitë që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat (fotokopje);

iii. letrën e angazhimit të çdo anëtari të personelit akademik të planifikuar për t'u angazhuar me kohë të pjesshme;

iv. lejen e punëdhënësit kryesor për anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme.

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike është si më poshtë:

a) shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të mësipërm kryhet nga një komision i ngritur me urdhër të ministrit, me përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, brenda 21 ditëve nga depozitimi i kërkesës së IAL-së dhe dokumentacionit shoqërues. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria i kërkon IAL-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) në rast se dokumentacioni konsiderohet i plotë, me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, miratohet hapja e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike.

KREU III

DISPOZITA E FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e



Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale arsimore parauniversitare, zyrtat vendore arsimore parauniversitare dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

ANEKS NR. 1

Fusha	Lëndët sipas planit mësimor në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë	Programi i Studimit (Diplomat e njëvlershme të ciklit të dytë “Master i shkencave”, “Master profesional” me kohëzgjatje 2 vjeçare, 120 ECTS) Sipas fushave të studimit
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe-letërsi	Studime në fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë
	Gjuhë e huaj	Studime në fushën e gjuhëve të huaja
Matematikë	Matematikë	Studime në fushën e matematikës
Shkencat e natyrës	Biologji	Studime në fushën e biologjisë
	Kimi	Studime në fushën e kimisë
	Fizikë	Studime në fushën e fizikës
Shoqëria dhe mjedisi	Shkenca sociale (Qytetari, Filozofi)	Studime në fushën e shkencave sociale
	Histori	Studime në fushën e historisë
	Gjeografi	Studime në fushën e gjeografisë
	Ekonomi	Studime në fushën e ekonomisë
Arte	Muzikë	Studime në fushën e muzikës
	Art Pamor	Studime në fushën e artit pamor
	Kërcim	Studime në fushën e koreografisë
	Teatër	Studime në fushën e teatrit
Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti	Edukim fizik	Studime në fushën e sporteve
Teknologji dhe Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	Studime në fushën e informatikës

UDHËZIM

Nr. 5, datë 17.2.2023

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE
KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, VITI
SHKOLLOR 2022-2023
(SESIONI I PARË)**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë për vitin shkollor 2022-2023 (sesioni i parë) do të zhvillohen në datat si më poshtë:

- a) Lënda “Gjuhë shqipe”, 20 qershor 2023.
- b) Lënda “Matematikë”, më 23 qershor 2023.
- c) Lënda “Gjuhë e huaj” e parë, më 26 qershor 2023.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare”. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare”, do të zhvillohet më datë 21 qershor 2023.

3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 72, datë 25.2.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”.

4. Gjuhët e huaja që do të jepen si provim i detyruar, janë: “Anglisht”, “Frëngjisht”, “Italisht”



dhe “Gjermanisht”. Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

6. Çdo provim kombëtar i arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 2 orë e 30 minuta.

7. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare greke, ndiqet procedura si vijon:

a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier.

b) Mësuesit dhe pedagogu që hartojnë testin propozohen nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar përkatësisht: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Finiq-Dropull, ZVAP Gjirokastrë-Libohovë, ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë dhe ZVAP Vlorë-Himarë.

c) Grupi i punës që përgatit testin mbledhet në ZVAP Finiq-Dropull.

d) Testi tërhiqet në ZVAP Finiq-Dropull.

e) Përfaqësuesit e ZVAP Gjirokastrë-Libohovë, ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë dhe ZVAP Vlorë-Himarë e tërheqin testin në ZVAP Finiq-Dropull, një ditë para provimit, ndërsa ata të ZVAP Finiq-Dropull e tërheqin testin në ditën e provimit.

8. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare maqedonase, ndiqet procedura si vijon:

a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Korçë.

b) Grupi i punës që përgatit testin mbledhet në DRAP Korçë.

c) Testi tërhiqet në DRAP Korçë.

d) Përfaqësuesit e ZVAP Korçë-Pustec e tërheqin testin në ditën e provimit.

9. Nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare të arsimit bazë, mbështetur në planin edukativ individual me të cilin punojnë në përshtatje me veçoritë e tyre.

10. Drejtuesi i institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, e tërheq testin në

Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.

11. Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVAP-në përkatëse, merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet DRAP-së në QSHA dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 77, datë 15.2.2023

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHËRIT TË
MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017, “PËR
MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE
NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të



PMB-ve”, i ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) në listën 2 miratohen për shtim 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) rinovohet regjistrimi për 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) zgjaten afatet e regjistrimit për 14 (katërmëdhjetë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

ç) hiqen 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

1. MIRATOHEN PËR SHTIM NË LISTËN 2, LËNDËT VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Aplikant	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	<i>Trichoderma atroviride</i> AT10	Nuk aplikohet	Përmbajtja nominale e <i>Trichoderma atroviride</i> AT10 në produktin teknik dhe formulimin është: Min: 1×10^{11} CFU/kg Nominal: 5×10^{11} CFU/kg Max: 1×10^{12} CFU/kg Nuk ka papastërti të spikatura.	Abiopep Plant Health SL	20.2.2023	20.2.2038	Të kushtohet vëmendje të veçantë në: - Specifikimin e materialit teknik si i prodhuar komercialisht i përdorur në produktet për mbrojtjen e bimëve, duke përfshirë karakterizimin e plotë të metabolitëve dytësorë; përkatës. - Mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat konsiderohen në vetvete si sensibilizues të mundshëm; Përdorimi i PPE/RPE mund të konsiderohet për të reduktuar ekspozimin e lëkurës dhe frymëmarrjes.
2	<i>Trichoderma atroviride</i> AGR2	Nuk aplikohet	Përmbajtja nominale e <i>Trichoderma atroviride</i> AGR2 në produktin teknik dhe formulimin është: Min: 5×10^{11} CFU/kg Nominal: 1×10^{12} CFU/kg Maximal: 1×10^{13} CFU/kg Nuk ka papastërti të spikatura.	Abiopep Plant Health SL	20.2.2023	20.2.2038	Të kushtohet vëmendje të veçantë në: - Specifikimin e materialit teknik si i prodhuar komercialisht i përdorur në produktet për mbrojtjen e bimëve, duke përfshirë karakterizimin e plotë të metabolitëve dytësorë përkatës; - Mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat konsiderohen në vetvete si sensibilizues të mundshëm; Përdorimi i PPE/RPE mund të konsiderohet për të reduktuar ekspozimin e lëkurës dhe frymëmarrjes.



2. RINOVOHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËN VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	<i>Pseudomonas chlororaphis</i> strain MA 342 Koleksioni i kulturës: NCIMB, UK: NCIMB 40616	Jo e aplikueshme	Sasia e metabolitit dytësor 2,3-deepoksi-2,3-didehidro-rizoksinë (DDR) në agjentin mikrobial të kontrollit të dëmtuesve (MPCA) nuk duhet të kalojë LOQ (2 µg/ml).	1.3.2023	28.2.2038	Mund të autorizohen vetëm përdorime si fungicide për veshjen e farave me makineri. T'i kushtohet vëmendje e veçantë: -nivelet të metabolitit 2,3-deepoksi-2,3-didehidro-rizoksinë (DDR) në agjentin mikrobial të kontrollit të dëmtuesve (MPCA), i cili nuk duhet të kalojë 2 µg/ml; -mbrojtjes së operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh se shtami MA342 i <i>Pseudomonas chlororaphis</i> duhet të konsiderohet, si çdo mikroorganizëm, si një sensibilizues i mundshëm dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë ekspozimit nëpërmjet thithjes. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. Aplikanti duhet të paraqesë informacion konfirmues në lidhje me: 1. identifikimin filogjenetik taksonomik të mikroorganizmit (identiteti, taksonomia dhe filogjenia); 2. metabolitin sekondar DDR, veçanërisht në shkallën e degradimit të tij; 3. potencialin për transferimin e gjeneve të rezistencës ndaj antibiotikëve nga shtami MA 342 i <i>Pseudomonas chlororaphis</i> te mikroorganizmat e tjerë.

3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- Deri më 31 tetor 2023:

1. Oxamyl

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2024:

1. Mecoprop-P

2. Pyraclostrobin

3. Metiram

4. Buprofezin

5. Dimoxystrobin

Gjithsej: 5 (pesë) lëndë vepruese.

- Deri më 29 shkurt 2024:

1. Flutolanil

2. Fluazinam

3. Mepiquat

Gjithsej: 3 (tri) lëndë vepruese.

- Deri më 2 mars 2024:

1. Benzovindiflupyr

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 31 mars 2024:

1. Cyflufenamid

2. Metsulfuron-methyl

3. Lambda-Cyhalothrin

4. Phosphane

Gjithsej: 4 (katër) lëndë vepruese.

4. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Benfluralin

Lënda vepruese benfluralin nuk është e rinovuar.

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë benfluralin, brenda datës 12 gusht 2023.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë benfluralin, të përfundojë brenda datës 12 maj 2024.

2. Lemon essential oil (*Citrus limon essential oil*)Lënda vepruese lemon essential oil (*Citrus limon essential oil*) nuk është e miratuar si substancë bazike.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.



URDHËR
Nr. 82, datë 16.2.2023

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe informacioni i përditësuar, i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
- b) zogjtë 24 orësh;
- c) shpendë dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezët e shpendëve;
- dh) mishi i shpendëve;
- e) nënproduktet e shpendëve.

Nga shteti i Bullgarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Sofia	Etropole	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24 orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 489, datë 24.10.2022, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare

me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 87, datë 20.2.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Enio Civici, nga data 20.2.2023 deri më datë 25.2.2023.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe



Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) Bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Në ushtrimin e kompetencave, sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose nga personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese. Zëvendësministri ndalohej të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Enio Civici.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

VENDIM
Nr. 12, datë 27.1.2023

**MBI HEQJEN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NR. 134, SERIA
PV11K, TË SHOQËRISË “DOSKU-
ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 8, germa “c”, dhe nenit 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.1.2023, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, Sekretari i Përgjithshëm dhe këshilltari i Bordit, me nr. 447 prot., datë 24.1.2023, “Mbi procedurën e nisur me vendimin nr. 188, datë 21.7.2022, në lidhje me fillimin e procedurës për

heqjen e licencës së shoqërisë ‘Dosku-Energy’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 21.7.2022, ka vendosur, ndër të tjera, fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k. për shkelje të kushtit të vendosur në pikën 2.2 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

- Në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe sa përcaktuar në vendimin e sipërcituar me shkresën nr. 207/20 prot., datë 1.8.2022, ERE ka njoftuar për këtë vendim shoqërinë “Dosku-Energy” sh.p.k., duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1507/2 prot., datë 6.9.2022, ka depozituar parashtrimet e saj.

- ERE iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), me shkresën nr. 1495 prot., datë 24.8.2022, me kërkesën për informacion mbi gjetjet në lidhje me kapacitetin e instaluar me të cilin operon shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. për HEC Gizavesh.

- Në kushtet që nuk u disponua informacion nga AKBN-ja për sa nga ERE kërkuar, me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 110, datë 8.9.2022, u urdhërua monitorimi i shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., me objekt verifikimin e kapacitetit të instaluar faktik krahasuar me kapacitetin e instaluar dhënë në licencën përkatëse.

- Në vijim të monitorimit të realizuar në datat 13-15.9.2022, grupi i monitorimit përgatiti informacionin përkatës nr. 454/5 prot., datë 27.9.2022, i cili, në zbatim të nenit 13, pika 4, të “Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 27.11.2020, ka përgatitur informacionin përkatës, i cili i është nisur shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. me shkresën nr. 454/6 prot., në datën 27.9.2022. Në shkresë referohet se brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e saj duhet të bëhet me dije në ERE qëndrimi apo kundërshtimi mbi sa konstatuar në informacionin përkatës.

- Shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/7,



datë 5.10.2022, shoqëria “Dosku-Energji” sh.p.k., ka kthyer përgjigje lidhur me informacionin e përgatitur nga grupi i monitorimit i ERE-s, dërguar me shkresën nr. 454/6 prot., në datën 27.9.2022.

- Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 253, datë 6.10.2022, vendosi, ndër të tjera, që shoqëria, brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i vendimit të Bordit të ERE-s, të depozitojë në ERE të gjithë dokumentacionin tekniko-financiar në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi për të gjitha asetet që shoqëria ka shtuar mbi listën e pajisjeve të impiantit për të cilën ajo është licencuar.

- Në vijim dhe bazuar në kërkesën e shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., protokolluar në ERE me nr. 207/36 prot., datë 7.11.2022, për vënie dokumentacioni në dispozicion, me vendimin nr. 282, datë 7.11.2022, bordi vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen e tij lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.

- Pas depozitimit në ERE të shkresës së AKBN-së nr. 1495/6 prot., datë 30.11.2022, në lidhje me verifikimin nga AKBN-ja të parametrave teknikë të HEC-it Gizavesh, me vendimin nr. 313, datë 6.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të pezullojë vendimmarrjen në lidhje me procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., deri në marrjen e një informacioni mbi këtë verifikim të njoftuar nga AKBN-ja.

- Më datë 29.12.2022, nga shoqëria “C&S Construction Energy” sh.p.k. është depozituar në ERE shkresa e AKBN-së nr. 520/20 prot., datë 27.12.2022, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me anë të së cilës AKBN-ja bën me dije konstatimet e verifikimit në terren duke evidentuar kryesisht gjetjet si më poshtë vijon: i) skema e shfrytëzimit për HEC Gizavesh përbëhet nga dy vepra marrjeje; ii) daljen e dy tubacioneve në formë T, të cilat furnizojnë godinën e HEC-it Gizavesh; iii) ujërat e këtyre burimeve orientoheshin drejt veprës së Gizaveshit, por pjesa ku derivimi interseктоhej me Lumin, nuk u arrit të konstatohej pasi Lumi kishte prurje të mëdha; iv) sipas skemës faktike dhe kuotave të matura, HEC-i Gizavesh shfrytëzon ujërat e zallit të Qarrishtës, pjesë e lumit Rapun dhe pellgut ujëmbledhës të lumit

Rapun, nga kuota $Z = 632$ m.n.d (marrja e ujit), deri në kuotën $Z = 439$ m.n.d (shkarkimi i ujit nga godina e HEC-it); v) kuota e veprës së marrjes së HEC Rapun 1 është $Z = 446.1$ m.n.d. HEC Gizavesh nuk mund të shfrytëzohet nga HEC Gizavesh nuk mund të shfrytëzohet më nga HEC Rapun 1; vi) mbikëqyrja e kontratës së koncesionit apo e respektimit të kuotave sipas përcaktimeve në këtë kontratë nuk është kompetencë e ERE-s, ndaj dhe vetë AKBN-së e ka orientuar dhe më herët këtë çështje për ndjekje në MIE.

- Në lidhje me verifikimin e planifikuar nga AKBN-ja, rezultoi se nuk ka të dhëna të reja apo përfundime në lidhje me kapacitetin e instaluar të HEC Gizavesh. Në këto rrethana vlerësohet se ka rënë shkaku i pezullimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 313/2022.

- Në lidhje me të gjithë procedurën administrative të ndjekur, rezultoi se grupi i monitorimit, pas realizmit të monitorimit në terren, dërgimit për objeksione të informacionit përkatës dhe marrjes së përgjigjes, nga shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/7 prot., datë 5.10.2022, si dhe shkresën nr. 207/31 prot., datë 21.10.2022, grupi i monitorimit në informacionin e tij përfundimtar me shkresë nr. 454/9, datë 2.11.2022, ka përfshirë në analizë edhe tabelat e nga raportimet periodike të prodhimit të prodhimit të HEC Gizavesh, të disponuara zyrtarisht nga raportimet periodike të Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a.

- Sipas përlllogaritjeve më të thelluara dhe referuar prodhimit mujor të raportuar nga FTL sh.a./OSHEE Group sh.a. për HEC Gizavesh për muajin prill 2021 = 379 mwh, edhe sikur të prodhonte me kapacitet të plotë dhe me prurje maksimale gjatë 24 orëve të ditës për 30 ditë, që praktikisht nuk është e mundur, i takon energjia orare e prodhuar të jetë 0.526 mw. Duke marrë në konsideratë dhe rendimentin e kësaj turbine, ku sipas targetimit të saj është 0.8, do t'i takonte që kapaciteti i instaluar, edhe pse në kushte jo të mundura, të ishte minimumi $0.526 \text{ mw} / 0.8 = 0.6575 \text{ mw}$). Në këto rrethana, HEC Gizavesh ka tejkaluar vlerën e lejuar në kushtet e licencës sa i takon kapacitetit të instaluar $\pm 10\%$, duke shkelur kushtin e vendosur në pikën 2.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, fakt për të cilin



nisi dhe procedura për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.

- Po ashtu, gjatë monitorimit, grupi i punës ka konstatuar se “Dosku-Energy” sh.p.k. në centralin HEC Gizavesh ka një aset/turbinë të shtuar në objekt, ndryshe nga numri i njërive gjenuesuese të përcaktuara në licencën përkatëse, dhe në kundërshtim me pikën 2.2 të kushteve të licencës ku parashikohet, se: i licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo ndryshim në fuqinë e instaluar të secilit prej njësive prodhuese ose centraleve elektrike të identifikuar në aneksin A, që rrisin ose ulin kapacitetin prodhues të disponueshëm nga i licencuari.

- Bazuar në raportimet vjetore e periodike të vetë shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., të administruara në ERE, në kuadër të përmbushjes së detyrimit të saj për sa përcaktuar në pikën 2.2 të kushteve të licencës, nuk rezulton që shoqëria të ketë njoftuar se ka shtuar këtë aset (turbinë), për të cilën në çdo rast duhet të ndiqej procedura e dhënies së autorizimit/miratimit nga ERE.

- Nga të dhënat që ERE kërkoi në lidhje me dokumentacionin përkatës tekniko-financiar të shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., konstatohet se subjekti nuk ka përcjellë në ERE asnjë dokument justifikues me anë të të cilit të vërtetonte vlerën e blerjes apo montimit të asetit të pretenduar, si dhe kohën kur ky i fundit është blerë. Po ashtu nuk dokumenton miratimin nga ERE.

- Përveç kërkesës së bërë në vitin 2013 për rritje të kapacitetit të instaluar, për të cilën i është kthyer përgjigje mbi dokumentacionin që duhet depozituar për të marrë miratimin në ERE për një kërkesë të tillë, në raportimin vjetor mbi veprimtarinë e licencuar për vitin 2016, shoqëria ka bërë me dije, se: është në fazën e oponencës dhe të miratimit të shtesës së fuqisë së instaluar në HEC në AKBN dhe miratimit të procedurave normale burokratike në instancat përkatëse. Në këto rrethana, rezulton se shoqëria ka qenë në dijeni të detyrimit për të marrë miratimet përkatëse përpara rritjes së kapacitetit.

- Në nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe në pikën

6.1, të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, parashikohet ndër të tjera, se: ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë sipas këtij ligji.

- Në nenin 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se: me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi i ERE-s ndër të tjera vendos, për: c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Rezulton se shoqëria ka shkelur kushtin e vendosur në pikën 2.2, të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, duke mos njoftuar ERE-n, si dhe duke tejkaluar vlerën e lejuar të kapacitetit të instaluar që kalon 10% të kapacitetit të identifikuar në aneksin A, parashikuar në pikën 2.3, të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016 ku është përcaktuar si vijon:

- 2.2 I licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo ndryshim në fuqinë e instaluar të secilës prej njësive prodhuese ose centraleve elektrike të identifikuar në aneksin A që rrisin ose ulin kapacitetin prodhues të disponueshëm nga i licencuari.

- Gjithashtu, në pikën 2.3 është parashikuar si vijon:

2.3 Çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë të kapacitetit të aneksit A, do të kërkojë një amendim të kësaj licence.

- Po ashtu subjekti ka shkelur kushtin e vendosur në pikën 3.2.2.5 të licencës, pasi nuk ka njoftuar ERE-n mbi asetin (turbinën) shtesë që është identifikuar në objekt nga grupi i monitorimit.

- Në pikën 3, të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është parashikuar se në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes apo furnizimit, ndaj të cilit është



vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve, ERE, bazuar në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së licencës, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara në germet “a”-“c” të këtij neni. Po ashtu, në pikën 5 të këtij neni është parashikuar se Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të këtij neni.

- ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 1864 prot., datë 26.10.2022, ku ka kërkuar qëndrimin e MIE-s në lidhje me zbatimin e masës së përkohshme më të përshtatshme dhe më të efektshme për të siguruar furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, si dhe kriteret dhe procedurën që do të ndiqet.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1864/1 prot., datë 24.11.2022, nuk ka propozuar një masë konkrete, por ka referuar zbatimin e përcaktimeve të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015.

Lidhur me sa më sipër, vërehet se në pikën 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, është përcaktuar vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Në çdo rast vlen të sqarohet se VKM nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, e ndryshuar, me anë të së cilës është vendosur detyrimi i shërbimit publik të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike ka karakter të përkohshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 134, seria PV11P, për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., dhënë

me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011, i ndryshuar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca dhe vendimi i sipërcituar humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Dosku-Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe shoqërinë “C&S Construction Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 16, datë 6.2.2023

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2023 PËR SHOQËRITË UJËSJELLËS-KANALIZIME, TË CILAT FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr.



481/1 prot., datë 2.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2023 për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”,

konstatohet se:

- Me shkresën nr. 565 prot., datë 24.1.2023, protokolluar me tonën me nr. 481 prot., datë 26.01.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për Shoqëritë e Ujësjellës-Kanalizime, të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV, si dhe 20/10/6 kV, të cilat aktualisht shërbejnë nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.), me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit me nr. 10253/1, datë 4.1.2023, ka miratuar, ndër të tjera, çmimin mesatar të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., me qëllim mbulimin e kërkesës për furnizim të shoqërive të ujësjellës-kanalizime, për vitin 2023, të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV, si dhe 20/10/6 kV prej 5.70 lekë/kWh.

- Gjithashtu, bazuar në pikën 2, të nenit 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcaktohet, se: “klientëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, i sigurohet furnizim i pandërprerë edhe në rast se kanë dalë në treg të liberalizuar dhe furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar”.

- Shoqëritë e Ujësjellës-Kanalizimeve janë ndër klientët me status të veçantë, të përcaktuar në pikën 1, të nenit 8, të VKM-së nr. 456/2022, si shoqëri të cilat sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve.

- Mbështetur në nenin 9, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë: kostot administrative,

tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje (3%).

- Për sa i përket kostove të imbalancave, nuk janë komponent i formulës së përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike, mbështetur në nenin 6 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, e ndryshuar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike nga shoqëria FSHU sh.a. janë në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Kthimi për riskun prej 3% do të jetë në vlerën 0.17 lekë/kWh.

- Komponentët e tjerë të përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për këtë kategori klientësh, në varësi të nivelit të tensionit ku janë të lidhur, janë tarifat e shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat janë miratuar me anë të vendimit nr. 73, datë 13.4.2022, dhe lënë në fuqi dhe për vitin 2023 me anë të vendimit nr. 324, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, si më poshtë vijon:

- **Për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV**

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE nr. 73, datë 13.4.2022, do të jetë 1.55 lekë/kWh.

- **Për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV**

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 20/10/6 kV në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 73, datë 13.4.2022, do të jetë 3.99 lekë/kWh.

- Në zbatim të metodologjisë, aplikimit të FSHU sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për shoqëritë ujësjellës-kanalizime, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë përlllogaritur si më poshtë:



Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për Shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime, Viti 2023			
VITI 2023		Nivelet e tensionit	
		35 kV	20/10/6 kV
	Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	5.70	5.70
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.17	0.17
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		9.33	11.77

- Bazuar në përcaktimet e metodologjisë respektive, elementet e formulës përlogaritëse si dhe të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë e ujësjellës-kanalizime për vitin 2023 do të jetë:

- 9.33 lekë/kwh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV;

- 11.77 lekë/kwh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2023, prej 9.33 lekë/kwh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2023, prej 11.77 lekë/kwh për shoqëritë -analizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

3. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 17, datë 6.2.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "SEKA HYDROPOWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "SEKË", ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 kw DHE "ZAI", ME KAPACITET TË INSTALUAR 2295 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 14962 kw"

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 451, germa "a" dhe "ç", të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë"; nenit 67 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016, si dhe pikës 5, germa "b", të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99,



datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike nr. 369/2 prot., datë 3.2.2023, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 10.9.2020, vendosi të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw, për një afat 28-vjeçar.

- Vendimi i Bordit të ERE-s, sipërcituar, është ankimuar gjyqësisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nga ana e palëve paditëse “B. P. etj.”, e cila me vendimin nr. 49, datë 18.1.2020, vendosi, ndër të tjera: 2. Shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ, vendim nr. 146, datë 10.9.2020, të Entit Rregullator të Energjisë për licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kw; dhe 3. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të kërimit si të pabazuar në ligj dhe në prova.

- Pas ankimit të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., ERE dhe Avokaturës së Shtetit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, kjo e fundit vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 49, datë 18.1.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendim ky, i cili u rekursua në Gjykatën e Lartë prej palëve të sipërcituara.

- Pas vendimmarrjes nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 29, datë 14.2.2022 vendosi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw.

- Në vijim të vendimmarrjes së mësipërme, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., kërkoi

rishikimin dhe pezullimin e këtij vendimi duke argumentuar se HEC “Zais” nuk ndodhet brenda zonave të mbrojtura, sipas hartave të publikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 59, datë 26.1.2022, “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore” dhe se vendimmarrja e Bordit të ERE-s nr. 29/2022, do t’i shkaktonte shoqërisë një dëm ekonomik të konsiderueshëm.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 39, datë 10.3.2022 vendosi të pranojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, duke i lënë shoqërisë, në cilësinë e palës së interesuar, që brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga marrja dijeni, të depozitonte në ERE aktin përkatës të ekspertimit ose çdo dokument tjetër të hartuar nga persona të licencuar të fushës, ku të vërtetohet se bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 59, datë 26.1.2022, HEC “Zais” ndodhet jashtë zonave të mbrojtura.

- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 19, datë 25.2.2022, vendosi pranimin e kërkesave të paraqitura nga ERE (përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit) dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., si dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 599 (86-2021-671), datë 10.11.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit.

- Referuar vendimit të mësipërm të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Bordi i ERE-s, ndër të tjera, me vendimin nr. 39/2022, vendosi pezullimin e zbatimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

- Në vijim, me vendimin nr. 96, datë 9.5.2022, Bordi i ERE-s, pas depozitimit nga ana e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., të sa lënë detyrë në plotësim të kushtit 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 39/2022, ku nëpërmjet dokumentacionit të nënshkruar nga ekspertë të fushës konfirmojë se HEC-et “Seka” dhe “Zais” ndodheshin jashtë zonave të mbrojtura mjedisore referuar VKM-së nr. 59, datë 26.1.2022, e po ashtu vendimit të



Gjykatës së Lartë, vlerësoi pranimin e kërkesës së shoqërisë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29/2022, duke e shfuqizuar atë për arsye se kishte rënë shkak për të cilin u mor ky vendim, çka e ktheu subjektin në gjendjen e mëparshme, sikurse licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020.

- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3410, datë 24.11.2022, vendosi përfundimisht “Mospranimin e rekursit të palës së paditur Shoqëria ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., Enti Rregullator i Energjisë dhe Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore, Tiranë, kundër vendimit nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit”.

- ERE-s i është vënë në dispozicion vendimi nr. 00-2022-3410, datë 24.11.2022 i zbardhur, nëpërmjet shkresës së Gjykatës së Lartë të protokolluar në ERE me nr. 369/1 prot., datë 26.1.2023.

- Kodi i Procedurës Civile, në nenin 451, germa “a”, ka parashikuar se: “vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët”, ndërsa germa “ç” e po këtij neni, parashikon se: “një vendim i gjykatës merr formë të prerë kur është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë”.

- Neni 67 i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon, se: “përveçse kur ligji parashikon shprehimisht një organ tjetër, ekzekutimi i detyrueshëm është në kompetencën e organit publik që ka nxjerrë aktin fillestar, pavarësisht nëse ai është ndryshuar apo zëvendësuar nga organi epror, si pasojë e ankimit administrativ, apo nga gjykata”.

- Gjithashtu, në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

- Në nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe në pikën 5.1, germa “b”, të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, është përcaktuar se ERE modifikon një licencë, me nismën e saj në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

- Për sa parashtrohet më lart, dhe për qëllime të unifikimit të praktikës me sa vendosur nga Gjykata e Lartë, vlerësohet të bëhet ndryshimi i pjesshëm i vendimit të licencimit të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., nr. 146, datë 10.9.2020 dhe shoqërisë t’i lëshohet licenca me ndryshimet përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, hiqen fjalët:

1. ... dhe “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw”.

2. Çdo akt tjetër i ERE-s që bie në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të vendimit si më sipër, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., Av. Dorina Ndreka, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 18, datë 6.2.2023****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“BALKAN ENERGY TRADE” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 82/6 prot, datë 3.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 341, datë 21.12.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 23.12.2022 dhe 24.12.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (datë 1.1.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Duke qenë se nga korrespondencat me shoqërinë, u konstatua mungesë e vërtetimit të gjendjes gjyqësore për administratorin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., (dokument që lëshohet nga një organ tjetër), Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pezulloi me 10 ditë pune vendimarrjen e tij në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për t'i dhënë mundësinë shoqërisë të depozitojë këtë dokument.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM
Nr. 21, datë 9.2.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“G.S.K.” SHPK NË VEPRIMTARINË
E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 67/10 prot., datë 3.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘G.S.K.’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 23.1.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.1.2023 dhe 25.1.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 2.2.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u publikua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të

ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezultoi se shoqëria “G.S.K.” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të rregullores së licencimit.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 22, datë 9.2.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“G.S.K.” SHPK NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 13



të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 67/11 prot., datë 3.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘G.S.K.’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 9, datë 23.1.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.1.2023 dhe 25.1.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 2.2.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “G.S.K.” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të rregullores së licencimit.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 23, datë 9.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NATYRE ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 566/1 prot., datë



7.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Natyre Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 566 prot., datë 3.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores së licencimit, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b” dhe “d”, për pikën 1.3, germën “a” dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “c”: Në kuptim të kërkesave të kësaj pike të rregullores, vihet re se shoqëria ka depozituar një strukturë të plotë sa i përket organizimit, por nuk ka bërë me dije nëse disponon stafin teknik, i cili është i punësuar apo do të punësohet në këto departamente për të ushtruar funksionet përkatëse, ndaj në vijim vlerësohet t’i kërkohej të depozitojë listën respektive.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “b”: Shoqëria pavarësisht statusit të Pezulluar për një periudhë të gjatë, ka detyrimin ligjor të hartojë pasqyra financiare edhe nëse rezultati është zero dhe t’i paraqesë ato në ERE për vitet 2020, 2021. Po ashtu, shoqëria duhet të paraqesë edhe bilancin kontabël për 6-mujorin e dytë për vitin 2022, (periudha kur ka qenë aktiv).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE edhe vendimin ortakëve të saj, në lidhje me vlerën

financiare që do të vërë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, vlerë kjo e cila duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacion vërtetues, nisur edhe nga fakti që sa më sipër llogaritet në referencë të sasive të parashikuara nga shoqëria për t’u tregtuar, rezulton se nuk mbulon asnjë muaj të ushtrimit të veprimtarisë.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, planin e biznesit, sipas kësaj kërkesë të rregullores.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 24, datë 9.2.2023

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“NATYRE ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 567/1 prot., datë 7.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Natyre Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 567 prot., datë 3.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën

1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b” dhe “d”; për pikën 1.3, germën “a” dhe për pikën 2.4, germën “a”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “c”: Në kuptim të kërkesave të kësaj pike të rregullores, vihet re se shoqëria ka depozituar një strukturë të plotë sa i përket organizimit, por nuk ka bërë me dije nëse disponon stafin teknik, i cili është i punësuar apo do të punësohet në këto departamente për të ushtruar funksionet përkatëse, ndaj, në vijim, vlerësohet t’i kërkohej të depozitojë listën respektive.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “b”: Shoqëria, pavarësisht statusit të pezulluar për një periudhë të gjatë, ka detyrimin ligjor të hartojë pasqyra financiare edhe nëse rezultati është zero dhe t’i paraqesë ato në ERE për vitet 2020, 2021. Po ashtu, shoqëria duhet të paraqesë edhe bilancin kontabël për 6-mujorin e dytë për vitin 2022 (periudha kur ka qenë aktiv). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE edhe vendimin ortakëve të saj në lidhje me vlerën financiare që do të vërë në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, vlerë kjo e cila duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacion vërtetues, nisur edhe nga fakti që sa më sipër llogaritet në referencë të sasive të parashikuara nga shoqëria për t’u tregtuar, rezulton se nuk mbulon as një muaj të ushtrimit të veprimtarisë.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE planin e biznesit, sipas kësaj kërkesë të rregullores.

Pika 2.4, “Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike”:

- Germa “b”: Aplikuesi nuk ka depozituar në ERE informacion në lidhje me sistemin IT, që do të operojë në veprimtarinë e furnizimit.

- Germa “c”: Aplikuesi nuk ka depozituar në ERE informacion në lidhje me ambientet ku do të ushtrohet veprimtaria e furnizimit.

- Germa “d”: Aplikuesi nuk ka depozituar në ERE informacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores.

- Në kuadër të mosplotësimit nga ana e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. të një pjese të konsiderueshme të dokumentacionit të këtij aplikimi, duke përfshirë këtu edhe



dokumentacionin teknik për këtë veprimtari si edhe faktin që në objektin e veprimtarisë së saj mungon furnizimi i energjisë elektrike, vlerësohet të mos fillohet procedura për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 25, datë 9.2.2023

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “SUN AVENUE” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 136/5 prot., datë 7.2.2023, të përparat nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 3, datë 10.1.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.1.2023 dhe 12.1.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 20.1.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 136 prot., datë 16.1.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 136/1 prot., datë 27.1.2023, dhe nr. 136/3 prot., datë 2.2.2023.



- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga ana e shoqërisë vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 26, datë 9.2.2023

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “SUN POWER 2017” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/5 prot., datë 7.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘SUN POWER 2017’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 10.1.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUN POWER 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.1.2023 dhe 12.1.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 20.1.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 134 prot., datë 16.1.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 134/1 prot., datë 27.1.2023, dhe nr. 134/3 prot., datë 2.2.2023.



- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga ana e shoqërisë vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “SUN POWER 2017” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “SUN POWER 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Ardjus Nexhi kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpalljen të zhdukur të shtetasit Osman Nexhi, i biri i Ibrahim dhe Hatixhesë, i datëlindjes 18.5.1969, lindur në Kukës dhe banues në Plug, Njësia Administrative Golem, Lushnjë dhe caktimin e djalit të tij Ardjus Nexhi kujdestar për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUES
Ardjus Nexhi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë